

Manual

PARANDALIMI
I RADIKALIZIMIT
DHE EKSTREMIZMIT
TË DHUNSHËM

Rehabilitimi dhe
riintegrimi i të kthyerve
nga zonat e konfliktit
nëpërmjet policimit
në komunitet

Manual

PARANDALIMI I RADIKALIZIMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Rehabilitimi dhe
riintegrimi i të kthyerve
nga zonat e konfliktit
nëpërmjet policimit në
komunitet

Ky manual është hartuar në kuadër të programit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”. Ky program po zbatohet në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, në bashkëpunim me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, si dhe Qendrën e Gruas për Zhvillim dhe Kulturë, nën koordinimin kombëtar të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, me financimin e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF).

Manuali është përgatitur nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në bashkëpunim me Departamentin për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri.



Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

Të nderuar kolegë/kolege,

Një nga kërcënimet e sigurisë publike në Shqipëri gjatë viteve të fundit është edhe përhapja e formave të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, ku roli i policimit në komunitet është i pazëvendësueshëm për të adresuar këto fenomene dhe rrjedhimisht për të kontribuar në qëndresën komunitare.

Gjatë viteve të fundit policimi në komunitet është kthyer në një mekanizëm të rëndësishëm të përmirësimit të efikasitetit të punës së Policisë së Shtetit. Nëpërmjet zbatimit të këtij modeli policimi, është rritur ndërveprimi dhe besimi midis komunitetit dhe policisë, në funksion të krijimit të një mjedisi sa më të sigurtë.

Punonjësit e policisë nëpërmjet policimit në komunitet identifikojnë personat e cenueshëm nga indoktrinimi në ekstremizëm të dhunshëm, në veçanti ata persona që janë në fazat e para të radikalizimit, të cilët nuk e pranojnë ende dhunën si formë legjitime në zgjerimin dhe mbrojtjen e bindjeve të tyre. Gjithashtu, nëpërmjet policimit në komunitet punonjësit e policisë ndihmojnë edhe në deradikalizimin, shkëputjen nga ekstremizmi i dhunshëm, si dhe rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit. Por për ta adresuar tërësinë e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm, nevojitet kontributi i të gjithë shoqërisë, ku punonjësit e policisë janë pjesë kyçe e këtij rrjeti aktorësh. Për këtë qëllim oficerët e policimit në komunitet duhet të punojnë së bashku me aktorët vendorë, si; organet e qeverisjes vendore, shkolla, familja, institucionet fetare, OJF-të, dhe aktorët e tjerë të interesit.

Në këtë kuadër vlerësoj edhe punën që po bëhet në drejtim të ngritjes dhe funksionimit të Këshillave Vendore të Sigurisë Publike pranë bashkive, si forume që angazhojnë qeverisjen vendore dhe të gjithë aktorët e tjerë në çështjet e sigurisë publike. Këshillat luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e sfidave kryesore në komunitetet përkatëse që lidhen me shkeljet e ligjit, natyrën e krimeve, sjelljet e dhunshme, identifikimin e problematikave të cilat rrezikojnë sigurinë e komunitetit dhe propozimin e zgjidhjeve të përshtatshme që mund të realizohen në nivel bashkie, si dhe rekomandimet për përmirësimin e sigurisë në komunitet.

Ky manual do të ndihmojë të gjithë oficerët e policisë, por në veçanti ata të policimit në komunitet për qasjen e tyre ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si dhe në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin e personave të kthyer nga zonat e konfliktit.

Në përfundim deshiroj të shpreh vendosmërinë e Policisë së Shtetit, për parandalimin e përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në vendin tonë, si dhe për të kontribuar në procesin e rehabilitimit dhe riintegritimit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit, duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët e tjerë.

*Ju uroj sukses në
përmbushjen e kësaj detyre të
rëndësishme.*

DREJTORI I PËRGJITSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Drejtues Madhor Gledis Nano



Fjalorth

Ekstremizmi i Dhunshëm - Përfaqëson fazën përfundimtare të procesit të radikalizimit dhe i referohet besimeve dhe veprimeve të njerëzve që mbështesin ose përdorin dhunën e motivuar ideologjikisht për të arritur objektivat politike, fetare ose ideologjike. Ekstremistët e dhunshëm nuk janë vetëm individët që janë të gatshëm të përqafojnë dhunën fizike, por edhe individët që mbështesin, rekrutojnë ose advokojnë në mënyrë aktive në favor të një ideologjie ekstremiste të dhunshme.

Lufta kundër Ekstremizmit të Dhunshëm - Nënkupton nisma dhe strategji që përqendrohen tek lufta kundër procesit të radikalizimit dhe frenimin e rekrutimit të ekstremistëve të dhunshëm. Është një reagim gjithëpërfshirës që synon mobilizimin dhe fuqizimin e aktorëve të ndryshëm si për shembull; institucionet e sigurisë, pushtetin vendor, arsimtarët, punonjësit socialë, komunitetin fetar dhe shoqërinë civile, me qëllim promovimin e vlerave qytetare dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm trajton edhe “kushtet që favorizojnë” përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, duke marrë parasysh dhe duke ndihmuar në zbutjen e zemërimit, që mund të shfrytëzohen nga ekstremistët dhe mbështetësit e tyre.

Luftëtarë të Huaj - I referohet individëve të cilët udhëtojnë drejt një shteti që nuk është shteti i tyre i qëndrimit apo nënshtetësisë, me qëllim kryerjen, planifikimin, përgatitjen dhe/ose pjesëmarrjen në akte terroriste apo ofrimin dhe/ose përfitim të trajnimit terrorist, qoftë ai edhe në lidhje me një konflikt të armatosur.

Qëndresa Komunitare / Komunitet i Qëndrueshëm - Mund të përkufizohet si cilësia e të qenit i aftë për t'u kthyer menjëherë në gjendjen e mëparshme pas problemeve, apo si aftësia për të përballuar, reaguar dhe për të marrë veten nga një sërë ngjarjesh të dëmshme dhe të pafavorshme. Komunitet i qëndrueshëm i referohet një ndërhyrjeje apo angazhimi aktiv të palëve të ndryshme të interesit të komunitetit, të veshur me autoritet për parandalimin apo luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Këtu përfshihet edhe qëndrimi i komunitetit ndaj një fenomeni të tillë dhe reagimi i tij në rast të një veprimtarie të ekstremizmit të dhunshëm apo të ngjarjeve që mendohet se i shkaktojnë ato.

Deradikalizimi - Është një proces që kryhet më së shumti përmes një sistemi programesh dhe masash që synojnë uljen e shkallës së pikëpamjeve ideologjike dhe riintegrimin e individëve të radikalizuar në shoqëri. Ky proces mbështetet te supozimi se jo të gjithë personat që radikalizohen qëndrojnë gjithmonë të angazhuar ndaj kauzës së tyre. Programet e deradikalizimit, në praktikë synojnë individët e radikalizuar gjatë fazave të ndryshme të ciklit ekstremist, i cili përfshin periudhën para se të bëhen pjesë e një grupi apo rrjeti, si anëtarë aktivë apo pas largimit të tyre. Qëllimi i këtij procesi mund të jetë pengimi i përfshirjes së tyre në dhunë (deradikalizimi i sjelljes), apo ndryshimi i qëndrimeve të tyre dhe supozimeve ideologjike (deradikalizimi i mendimeve).

Shkëputja nga Ekstremizmi i Dhunshëm - I referohet një qasjeje restauruese që inkurajon një individ të heqë dorë nga normat, vlerat, qëndrimet dhe aspiratat e përbashkëta të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Shkëputja mund të jetë fizike, e cila nënkupton largimin fizik të individit nga grupi - dhe/ose psikologjike - që nënkupton shkëputjen e mendimeve të individit nga përfshirja në aktivitetet e grupit. Shkëputja nuk do të thotë domosdoshmërisht që një person ka ndryshuar ideologjikisht bindjet e tij, por përkundrazi sjellja e tyre e largon atë nga rrethanat e lidhura më parë me grupin e tyre të mëparshëm.

Programet e Rehabilitimit dhe Riintegritit - Programe që u drejtohen individëve të radikalizuar për akte të dhunshme përfshirë (po jo vetëm) ata që kanë kryer vepra që lidhen me terrorizmin dhe disa herë edhe familjet e tyre, si dhe atyre që nuk kanë hyrë në sistemin e burgjeve, por mund të shfaqin në një farë mase mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm, përfshirë ata që janë kthyer nga Siria dhe Iraku. Programet e rehabilitimit dhe riintegritit zhvillohen brenda burgjeve, jashtë konteksteve të heqjes së lirisë, në komunitete, ose si pjesë e shërbimit të provës. Programet mund të ofrojnë trajnim arsimor dhe profesional, këshillim, mundësi punësimi, dhe riedukim ideologjik. Ndërsa rehabilitimi dhe riintegriti me bazë komunitetin, nënkupton një tërësi nismash të cilat sigurojnë që individët e kthyer, gëzojnë të njëjtat të drejta e të njëjtat mundësi si dhe anëtarët të tjerë të komunitetit. Si për shembull; qasja në shërbimet shëndetësore, edukim, formim profesional, punësim, angazhim në vendimmarrjen vendore etj.

Rehabilitimi - Është faza kur personat përgjegjës ndërmarrin ndërhyrje për të trajtuar sjelljen dhe aftësitë njohëse të të kthyerve, si dhe zhvillojnë aktivitete përgatitore për të përforcuar qëndresën personale të individit ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe për t'i përgatitur ata për riintegrim shoqëror. Kjo mund të ndodhë pas fazës së shkëputjes dhe/ose deradikalizimit dhe gjithashtu mund të ndodhë në të njëjtën kohë me këto procese. Veçanërisht, në kontekstin e luftës ndaj ekstremizmit të dhunshëm, rehabilitimi përqendrohet në qëndrueshmërinë e posaçme ndaj ekstremizmit të dhunshëm, duke i rezistuar tërheqjeve të grupit të tyre të mëparshëm dhe siguron gatishmërinë e individit për riintegrim funksional shoqëror dhe largimin nga sjellja kriminale.

Riintegriti - Është faza ku punonjësit ndihmojnë kalimin e individit të rehabilituar përsëri në "kushtet e dëshiruara" në shoqërinë e zakonshme. Në të njëjtën kohë, punonjësit gjithashtu duhet të punojnë me komunitetin specifik ku ai individ përfundimisht do të banojë, për të zbutur stigmën sociale dhe të punojnë drejt pranimit të atij individit në shoqëri. Duhet gjithashtu të theksohet se në disa raste, kjo fazë në të vërtetë mund të konsiderohet "integrit" më shumë se "riintegrit", për shkak të rrethanave të mëparshme shoqërore të individit për të mos u integruar në fillim. Megjithatë, përderisa termi "riintegrit" pranohet gjerësisht, edhe në këtë manual përdoret i njëjti term.

Përmbajtja

Fjalorth	5
Qëllimi i manualit	8
Konteksti i ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Sfidat dhe nxitësit	10
Roli i policimit në komunitet, në parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm	15
Bashkëpunimi i policisë me institucionet e tjera shtetërore dhe joshtetërore për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm	21
Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me institucionet e tjera shtetërore	22
Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me rininë	23
Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me organizatat për të drejtat e grave/vajzave	24
Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me institucionet fetare	25
Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me minoritetet etnike	26
Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me organizatat e shoqërisë civile (OSHC)	27
Roli i policisë në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin të personave të kthyer nga zonat e konfliktit	30
Konsideratat etike dhe zbatimin e të drejtave të njeriut gjatë veprimeve të policisë	35

Qëllimi i manualit

Shqipëria, ashtu si shumica e shteteve të tjera, përballet me forma të ndryshme kërcënuese të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, të cilat rrezikojnë paqen dhe sigurinë në vend. Policia e Shtetit, si institucioni kryesor i ruajtjes së paqes dhe sigurisë në vend, ka rol thelbësor në përbaljen me këto fenomene. Për shkak se radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm janë fenomene të cilat nuk mund të luftohen vetëm me “forcë”, por nevojitet edhe “qasja e butë”, shtetet tashmë i kushtojnë rëndësi edhe mjedisit në të cilin mundësohet ky fenomen. Kjo bëhet nëpërmjet punës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, deradikalizimit, rehabilitimit dhe riintegrit të personave që kanë qenë të përfshirë ose viktime të ekstremizmit të dhunshëm.

Ky manual për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit, i shërben të gjithë oficerëve të policisë, të cilët pozicioni i punës i lidh drejtpërdrejt apo tërthorazi me individët e cenusshëm dhe viktimat e këtij fenomeni. Si i tillë, manuali është një dokument praktik që lehtëson punën e punonjësve të policisë në forcimin e qëndresës komunitare ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Manuali nuk ka në fokus vlerësimin e rrezikshmërisë së individëve që mbështesin ekstremizmin e dhunshëm, pasi ndjekja penale e tyre, ashtu si dhe parandalimi i veprimeve terroriste, është përgjegjësi dhe ekspertizë e njësive të specializuara të policisë, agjencive të inteligjencës dhe autoriteteve të tjera përkatëse.

Duke u bazuar në dinamikën dhe kompleksitetin e fenomenit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, ky material ndërtohet nën të ashtuquajturën “qasje e butë” dhe i kushton rëndësi të veçantë rehabilitimit dhe riintegrit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit. Megjithatë, roli, detyrat dhe karakteristikat e punonjësve të policisë që përmenden në këtë material, mund të gjejnë zbatim në të gjithë spektrin e qëndresës komunitare. Ky manual informon oficerët e policisë për qasjen e tyre ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm; bashkëpunimin me aktorët e tjerë në nivel vendor, si dhe ndërgjegjësimin dhe bashkëpunimin me komunitetet vendore për të siguruar suksesin e forcimit të qëndresës komunitare, dhe më specifikisht rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve.

Manuali është i strukturuar në pesë pjesë kryesore. Fillimisht trajtohet konteksti i ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, sfidat dhe nxitësit; ndërsa pjesa e dytë shpjegon rolin e policimit në komunitet për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Pjesa e tretë përqendrohet tek bashkëpunimi i policisë me institucionet e tjera shtetërore dhe jo shtetërore për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm; pjesa e katërt shpjegon rolin e policisë në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit të luftëtarëve të huaj terroristë; dhe së fundmi, nënvizohen konsideratat etike dhe zbatimi i të drejtave të njeriut gjatë veprimeve të policisë.

Konteksti i ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Sfidat dhe nxitësit

Shqipëria renditet si vendi i tretë në Ballkanin Perëndimor me numrin më të lartë të shtetasve të larguar drejt Sirisë dhe Irakut, bazuar në popullsinë e përgjithshme, dhe si eksportuesi më i ulët i shtetasve, bazuar në rekrutimet mes popullatës myslimane. Sipas të dhënave zyrtare, rreth 144 shtetas shqiptarë iu bashkuan konfliktit në Irak dhe Siri gjatë viteve 2012-2014.¹

Tabela 1: Paraqitje tabelore, pjesëmarrja e shtetasve shqiptarë në konfliktin sirian.

Nr.	Persona	Larguar sipas viteve				Në vitin 2017 në zonat e konfliktit	Të dyshuar të vrarë	Të kthyer (2012-2014)	Të përfshirë gjithsej	Të riatdhesuar (2020-2021)
		2012	2013	2014	2015-2021					
1	Meshkuj	7	55	17	0	23	26	30	79	0
2	Femra	0	20	7	0	20	0	7	27	6
3	Fëmijë	0	33	5	0	30	0	8	38	18
Gjithsej		7	108	29	0	73	26	45	144	24

Burimi: Dr. Xhavit Shala, Msc. Gledis Nano, Ekstremizmi i dhunshëm dhe ISIS, rrezik dhe kërcënim për sigurinë, publikuar në "Policimi dhe Siguria" Nr.7, 2017; 64. (Shënim i autorit: Tabela është përditësuar nga autori i manualit, duke përfshirë edhe riatdhesimet e viteve 2020-2021).

1 Vendim i Këshillit të Ministrave 1137/2020. Strategjia Ndërsektoriale për Luftën kundër Terrorizmit, 2021–2025, dhe Plani i Veprimit 2021–2023. E disponueshme në www.cve.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/vendim-2020-12-16-1137.pdf;17.

Ndonëse fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm nuk paraqet të njëjtin nivel kërcënimi si disa vite më parë, për shkak të forcimit të kuadrit ligjor, politik, institucional, zbatimit të Strategjisë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, si dhe në sajë të ngritjes së kapaciteteve për parandalimin/luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, ky fenomen mbetet ende i pranishëm në Shqipëri në forma të ndryshme.² Propaganda në internet ka luajtur një rol qendror në nxitjen e shtetasve shqiptarë për të luftuar në konfliktin sirian, dhe në disa raste kjo propagandë ka synuar të tërheqë audiencën shqipfolëse duke përzier mesazhet fetare me propagandën e ISIS-it.³ Raporti i Shërbimit Informativ të Shtetit⁴ për vitin 2020 konfirmon se gjuha shqipe vijon të ketë një vend të konsiderueshëm në hapësirën online për sa u përket materialeve propagandistike terroriste.

Studimet në Shqipëri tregojnë se faktorët që kontribuojnë në radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm janë ideologjike, socio-ekonomike dhe strukturore. Ato janë zakonisht një kombinim kumulativ i qeverisjes joefektive (institucionet), kohezionit të dobët shoqëror (komunitetet), besimeve dhe sjelljeve ekstremiste personale (ideologjia).⁵ Studimet sugjerojnë t'i kushtohet vëmendje radikalizimit si fenomen dhe jo thjesht pasojave të tij, si p.sh. ikja e qytetarëve drejt Sirisë.⁶ Kjo ka një rëndësi të veçantë pasi fluksi i të larguarve drejt Sirisë apo Irakut nuk ishte fillimi i radikalizimit, por më tepër rezultati i një procesi të hershëm. Megjithatë, ky fluks shërbeu për të ilustruar se si rritja e radikalizimit të brendshëm kishte ndodhur pa u vënë re dhe se si qasja e përgjithshme e politikës së Shqipërisë nuk ishte e përgatitur për t'u përballur me natyrën evoluese të kërcënimeve terroriste.⁷

•••

- 2 Strategjia Ndërsektoriale për Luftën kundër Terrorizmit 2021 - 2025 thekson se Shqipëria, përveç se është sfiduar me ekstremizmin me bazë radikale religjioze, ballafaqohet edhe me forma të tjera, siç janë ato me motive nacionaliste apo etnike për të arritur qëllime të caktuara politike.
- 3 Projekti kundër Ekstremizmit 2017, Shqipëria: Ekstremizmi dhe lufta kundër tij. New York.
- 4 Shërbimi Informativ i Shtetit, 2021. Gjendja e Sigurisë në Republikën e Shqipërisë 2020. E disponueshme në www.shish.gov.al/pages/lajme/raporti_2020.html.
- 5 Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Perspektivat Komunitare në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri, Raport studimor, Berlin, Berghof Foundation 2018.
- 6 Gjergji Vurmo dhe të tjerë, Radikalizmi Fetar në Shqipëri, Raport Studimor. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Tiranë 2015.
- 7 Mandrit Kamolli dhe Arjan Dyrmishi, Qasja e Shqipërisë për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm: Zbatimi, Rezultatet dhe Përafrimi me Qasjet dhe Kuadrin e BE-së. Dokument Politikash, Tiranë: Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes 2018; 32-33.

Faktorët e përgjithshëm shtytës që mund të ndikojnë në radikalizim:	Faktorët e përgjithshëm tërheqës që mund të ndikojnë në radikalizim:
Papunësia	“Idealet” e shtrembëruara nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, si p.sh. ideja e kalifatit apo arritja e barazisë social-ekonomike
Mungesa e qasjes në arsim	
Margjinalizimi etnik	
Cenueshmëritë individuale:	Nxitësit individualë:
Zemërimi për shkak të papunësisë	Përkatësia (identiteti) e fituar në grupin ekstremist të dhunshëm
Mungesa e identitetit personal	
Shkëputja nga shteti/familja	Stimujt financiarë që ofrohen nga grupi ekstremist i dhunshëm
Ekspozimi ndaj grupeve/individëve të ekstremizmit të dhunshëm në lagje	Dëshira për aventurë

Burimi: Hedayah, 2021, Faktorët që kontribuojnë në radikalizim: Një kuadër konceptual. E disponueshme në https://hedayahcenter.org/app/uploads/2021/10/Factors-Contributing-to-Radicalization_a-conceptual-framework_Final.pdf.

Radikalizimi është një proces që mund të ndodhë shpejt, por mund të kërkojë edhe një kohë të gjatë. Duke qenë i tillë, krijohen mundësi për identifikimin e hershëm të rreziqeve dhe gjetjen e zgjidhjes më të përshtatshme për të mbrojtur dhe larguar njerëzit nga ky fenomen. Disa nga shenjat paralajmëruese të personave të radikalizuar jepen më poshtë, por kjo listë shenjash paralajmëruese të personave të radikalizuar nuk është shteruese, sepse individë të caktuar mund të shfaqin shenja të ndryshme nga njëri-tjetri.


- **Luhatje temperamenti**, humbje e interesit në mënyrë të papritur dhe drastike, si dhe distancim nga aktivitetet e mëparshme, familja apo miqtë.
- **Krijimi i miqësive të reja**, që fshehin identitetin e tyre dhe ndikojnë negativisht mbi të.
- **Luhatje në karakter**, ndryshime të papritura dhe drastike në pamje ose në veshje.
- **Ndryshime të përgjithshme në humor**, gjendje shpirtërore dhe sjellje të luhatura lidhur me ushqimin, gjuhën ose financat (duke kursyer apo duke shpenzuar para në mënyrë të papritur).
- **Ndryshimet në sferën sociale**, komente antisociale, refuzim të autoritetit,

refuzim për të bashkëvepruar në mënyrë shoqërore, tërheqje dhe izolim.

- **Të folurit në mënyrë të përçarë**, “ata dhe ne”, apo me terma përçmues ndaj të tjerëve që janë të ndryshëm, duke refuzuar të merren me ta ose duke abuzuar ndaj tyre.
- **Shprehja e pikëpamjeve radikale** apo mbështetja e pikëpamjeve të tilla, duke justifikuar veprimet e radikalistëve, duke mbështetur mesazhe ekstremiste, akte apo mjete të dhunshme.
- **Rritja e ndjeshmërisë** ndaj teorive apokaliptike e konspirative dhe ndjenjave të persekutimit.
- **Interesimi i papritur** për politikën e brendshme ose të jashtme, duke shfaqur mosbesim dhe irritim ndaj politikëbërësve.
- **Përdorimi i literaturës** dhe imazheve ekstremiste.
- **Vendosja e kontakteve me rekrutuesit ekstremistë**, duke u bashkuar ose duke u përpjekur për t’u bashkuar me organizatat ekstremiste.
- **Përpjekje për të rekrutuar të tjerë** në ideologji ekstremiste.
- **Përgatitje për të thënë lamtumirë.**
- **Të qenët i fshehtë dhe ngurrues** për të diskutuar aktivitetet, vendndodhjen, bashkëpunëtorët.
- **Kalimi i kohës së tepërt në internet ose në telefon**, duke ndryshuar identitetin online, duke zotëruar telefona celularë ose pajisje të ngjashme dhe duke i mbajtur ato private në mënyrë strikte.

Duke qenë se ka një shumëllojshmëri faktorësh dhe nxitësish të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, edhe përpjekjet kundër këtij fenomeni duhet të adresojnë të gjitha elementet, nëpërmjet një qasje të bashkërenduar ndërinstitucionale dhe shumaktoriale. Kjo qasje përfshin edhe institucionet shtetërore qendrore dhe vendore, punonjësit e vijës së parë, të tilla si shërbimet psiko-sociale, shkollat dhe komuniteti pritës. Për të parandaluar përhapjen e rrezikut të mundshëm për sigurinë në komunitet, nevojitet pikërisht ndërtimi i partneriteteve mes aktorëve të ndryshëm, të cilët adresojnë gradualisht kontekstin e përgjithshëm shoqëror, ekonomik dhe kulturor që ushqen sjellje ekstremiste të dhunshme, veçanërisht tek të rinjtë. Bashkërendimi i punës mes të gjithë aktorëve shmang mbivendosjen dhe mundëson ofrimin e një përgjigjeje të sinkronizuar dhe më të plotë ndaj këtij fenomeni, si dhe rrit mundësitë për të arritur rezultate të suksesshme.

Roli i policimit
në komunitet, në
parandalimin e
radikalizimit dhe
ekstremizmit të
dhunshëm

The bottom half of the page features abstract geometric lines. A thin white line starts from the left edge and extends diagonally down towards the center. Another thin white line starts from the right edge and extends diagonally down towards the center. These two lines meet at a point near the bottom center, forming a large, open 'V' shape. The lines are thin and white, contrasting with the dark blue background.

Roli i policimit në komunitet, në parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Një nga kërcënimet e sigurisë publike në Shqipëri gjatë dekadës së fundit, është paraqitur nga përhapja e formave të ekstremizmit të dhunshëm, ku roli i policimit në komunitet është i pazëvendësueshëm për të adresuar këtë fenomen. Ky rol theksohet në Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm 2015-2020, ku një nga dhjetë masat e së cilës është krijimi i besimit dhe rritja e sigurisë së komunitetit, përmes policimit në komunitet.⁸ Strategjia në të njëjtën kohë nënvizon se bashkërendimi i institucioneve qeveritare, veçanërisht i Policisë së Shtetit me aktorët e komunitetit lokal, është kyçe në nxitjen e përpjekjeve të mbështetura në partneritet për identifikimin, parandalimin dhe zgjidhjen e krimeve në mënyrë më efektive.⁹ Përgjegjësia e policimit në komunitet në këtë kuadër theksohet edhe nga strategjia kombëtare,¹⁰ ku Departamenti për Sigurinë Publike, ngarkohet të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të masave të zgjerimit dhe rritjes së aftësive të policimit në komunitet për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Në mënyrë që roli i Policisë së Shtetit të jetë sa më i efektshëm në komunitet, nevojitet që komunitetet lokale të trajtohen nga Policia e Shtetit si partnerë dhe jo vetëm si informatorë ose asete të grumbullimit të informacionit, pasi kjo mënyrë mund të jetë më e efektshme për të rritur besimin dhe nxitur mbështetjen e komunitetit.¹¹

Nevoja për të përmirësuar rolin e policimit në komunitet theksohet edhe tek Strategjia Ndërsektoriale për Sigurinë në Komunitet,¹² ku përcaktohet si objektiv specifik përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të

8 Strategjia Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm 2015-2020. www.cve.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/2015-Strategjia-Kombëtare-Kundër-Ekstremizmit-të-Dhunshëm.pdf.

9 Strategjia Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm 2015-2020 www.cve.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/2015-Strategjia-Kombëtare-Kundër-Ekstremizmit-të-Dhunshëm.pdf.

10 Strategjia Ndërsektoriale për Luftën kundër Terrorizmit, 2021–2025, dhe Plani i Veprimit 2021–2023. E disponueshme në www.cve.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/vendim-2020-12-16-1137.pdf; 43.

11 GCTF, 2019. Praktika të mira për adresimin e sfidës së kthimit të familjarëve të luftëtarëve të huaj terroristë. E disponueshme në www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Framework%20Documents/2018/GCTF-Good-Practices-on-Returning-Families-of-FTFs_ENG.pdf?ver=2018-09-25-101427-323; 13.

12 Strategjia Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021–2026 dhe Plani i Veprimit 2021–2023.

posaçme të dedikuar për policimin në komunitet. Strategjia nënvizon më konkretisht përmirësimin e funksionit të Ndihmës Specialistit të Policimit në Komunitet NSPK/SPZ, në zonën e tij të policimit, pasi policim në komunitet kryejnë të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit. Ky funksion supozohet të jetë posaçërisht për policimin në komunitet (për kryerjen e aktiviteteve me fokus komunitetin dhe forcimin e bashkëpunimit me të gjithë aktorët e tjerë që operojnë në zonën policore), duke mos pasur më rol “represiv” siç funksionon aktualisht, por ka edhe përgjegjësi të tjera. Objektivi i strategjisë është në përputhje me rolin e kërkuar të policimit në komunitet, për të adresuar fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm, procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin të të kthyerve, duke qenë më afër komunitetit dhe duke forcuar partneritetin me aktorët vendorë.

Parimi qendror i policimit në komunitet është rritja e nivelit të pjesëmarrjes së komunitetit në rritjen e sigurisë në komunitet, si edhe në zgjidhjen e krimeve që ndikojnë komunitetet, sepse policia në vetvete dhe e vetme nuk mund ta kryejë dot këtë detyrë. Ndihmës Specialisti i Policimit në Komunitet, SPZ, si dhe të gjithë punonjësit e tjerë të policisë, për të qenë efikasë në përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, duhet të zotërojnë edhe disa aftësi dhe njohuri, si:

- Njohuri mbi legjislacionin vendas dhe procedurën standarde për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.
- Njohja e fenomenit të terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, duke përfshirë faktorët shtytës dhe tërheqës, që mund ta vendosin një individ në rrezik për ekstremizëm të dhunshëm.
- Trajnim i specializuar për të drejtat e njeriut në kuadrin e antiterrorizmit.
- Identifikimi i rrethanave apo sjelljeve të dyshimta dhe vlerësimi i opsioneve për ndërhyrje, pa u bazuar tek praktika të profilizimit mbi baza diskriminuese dhe duke mbajtur parasysh që opinionet radikale apo ekstreme nuk duhen konsideruar si krim, në rast se ato nuk lidhen me dhunë apo veprime të tjera të paligjshme, sipas përshkrimit të jurisprudencës, në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.
- Të kuptuarit se si terroristët mund të përpiqen të përfitojnë nga një komunitet për të gjetur mbështetje, për t’u fshehur, për të bërë kontrabandë, për të mbledhur fonde, armë dhe/ose eksplozivë.
- Dijeni për shënjestra të caktuara terroriste/veprime të dhunshme në komunitetin e tyre.
- Të kuptuarit e çështjeve delikate dhe rreziqeve të përfshirjes së pjesëtarëve të publikut në përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.
- Trajtimi i kërkesave nga publiku dhe media lokale në lidhje me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.
- Për çfarë çështjesh duhet të jenë vigjilentë gjatë punës së tyre, duke përfshirë

edhe ndikimin e mundshëm të veprimeve të tyre mbi të drejtat e njeriut, si edhe mënyrat e trajtimit të dëshmitarëve dhe nevojat imediate të viktimave, duke garantuar njëkohësisht sigurinë e tyre dhe duke mbrojtur të drejtën e tyre të fshehtësisë.

- Si të mbajnë shënim, ku dhe si të raportojnë informacione apo shqetësime të caktuara.
- Cilat janë rrethanat/situatat ku kërkohet veprimi i tyre i menjëhershëm dhe si duhet të veprojnë ata në këto rrethana.
- Nëse dhe si janë të autorizuar për të bashkëvepruar me publikun për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Shkalla e hierarkisë për Ndhmës Specialistët e Policimit në Komunitet dhe për të gjithë punonjësit e tjerë të policisë, duhet të jetë e qartë dhe të specifikojë:

- Kush përgjigjet për raportimin jashtë shkallës së drejtpërdrejtë të hierarkisë, në varësi të natyrës dhe urgjencës së problemit dhe informacionit që disponohet.
- Cilat probleme dhe çfarë informacioni duhet të raportohet në struktura të tjera të policisë, agjenci apo autoritete publike, dhe cilat janë procedurat standarde dhe kanalet e komunikimit për këto raste.
- Cilat janë përgjegjësitë individuale të punonjësve të policisë për dokumentimin dhe regjistrimin e informacionit të saktë në lidhje me veprimtaritë e policimit në komunitet që kanë të bëjnë me parandalimin e terrorizmit dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, me qëllim garantimin e mbikëqyrjes dhe logaridhënies efikase në punën e tyre.

Drejtuesit e strukturave policore për të qenë të suksesshëm në zbatimin e policimit në komunitet në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, kërkohet:

- Të përzgjedhin punonjësit e policisë së policimit në komunitet, duke pasur parasysh që ata:
 - » Të reflektojnë demografinë e komunitetit ku ata shërbejnë.
 - » Të kenë përvojën e përshtatshme.
 - » Të përfaqësojnë përbërjen e duhur nga këndvështrimi gjinor.
 - » Të kenë aftësi dhe dije profesionale.
 - » Të kenë besueshmëri që nevojitet për ndërtimin e marrëdhënieve efikase me komunitetin.
- Të inkurajojnë punonjësit e policisë që kanë dije dhe ekspertizë shtesë, të aplikojnë për në seksionet e policimit në komunitet. (Aftësitë shtesë ku mund të përfshihen: njohja dhe zotërimi i një apo dy gjuhëve të huaja, si dhe të ketë dijeni apo njohje të një besimi apo minoriteti etnik të caktuar).

- Të planifikojnë masa për zhvillimin profesional të punonjësve të policimit në komunitet.
- Të përfshijnë stimuj dhe masa shoqëruese për të garantuar që kompetencave, dijeve dhe aktiviteteve të policimit në komunitet, u jepet vëmendja e duhur dhe që ato bëhen pjesë e proceseve të promovimit në detyrë.
- Të nxisin dijet dhe aftësitë që ekzistojnë brenda komuniteteve lokale, me qëllim përmirësimin e trajnimit të punonjësve të policisë. Duke përfshirë vetë komunitetin në hartimin dhe zbatimin e trajnimeve për punonjësit e policimit në komunitet, drejtuesit e policisë vendore, mund të nxisin përpjekjet e përbashkëta midis publikut dhe policisë.

Nga Ndhmës Specialistët e Policimit në Komunitet në Komisaritet e Policisë, kërkohet:

- Të zhvillojnë aftësitë për ndërmjetësim dhe menaxhim konfliktesh, aftësi drejtimi apo ndërmjetësimi në takimet që bëhen në komunitet.
- Të zhvillojnë aftësitë për komunikim, duke përfshirë aftësitë për prezantim dhe dëgjim.
- Të zhvillojnë njohuritë dhe dijet në lidhje me barazinë, diversitetin dhe të drejtat e njeriut.
- Të zhvillojnë në vazhdimësi aftësitë profesionale.

Punonjësi i policisë mund të kontribuojë për parandalimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si më poshtë:

Angazhohet	<ul style="list-style-type: none"> ■ Takohet dhe ndërton marrëdhënie me komunitetin. ■ Takohet dhe ndërton partneritete me organizatat komunitare, grupet fetare, akademikët dhe median lokale. ■ Mban lidhje me anëtarët e komunitetit edhe nëpërmjet medias sociale.
Ndërton besim	<ul style="list-style-type: none"> ■ Ndërton një dialog të sigurtë dhe të hapur ndërmjet punonjësve të policisë dhe anëtarëve të komunitetit. ■ Mundohet të kuptojë problematikat dhe historinë e komuniteteve dhe promovon mirëkuptim. ■ Njeh nevojat dhe pikat e forta të komunitetit; si reagon ndaj situatave emergjente. ■ Të jetë sa më transparent me komunitetin, të respektojë të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor.

Ndërgjegjëson	<ul style="list-style-type: none"> ■ Forcon njohuritë dhe ndërgjegjësimin e komunitetit rreth krimeve (përfshirë krimet e urrejtjes), punën e policisë dhe burimet e komunitetit për të luftuar krimet. ■ Forcon njohuritë dhe ndërgjegjësimin e komunitetit rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër tij.
Zgjidh problemet	<ul style="list-style-type: none"> ■ I ofron komuniteteve njohuri dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve se si të reagojnë ndaj tensioneve që lidhen me gjuhën e urrejtjes dhe krimet. ■ Nxit ndërgjegjësimin e komunitetit rreth islamofobisë dhe mënyrave për ta sfiduar atë. ■ I ofron komuniteteve njohuri dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve se si të vlerësojnë nivelin e rrezikut për ekstremizmin e dhunshëm dhe si të marrin ndihmë. ■ I ofron komuniteteve informacion në lidhje me burimet e disponueshme për individët e rrezikuar (p.sh. shëndeti mendor, etj).
Mobilizon	<ul style="list-style-type: none"> ■ Promovon angazhimin dhe bashkëpunimin mes anëtarëve të komunitetit për forcimin e qëndresës komunitare. ■ I ofron komuniteteve njohuri dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve, veçanërisht trajtimin e çështjeve të ekstremizmit të dhunshëm. ■ Promovon lidhshmërinë e grave dhe të rinjve në çështjet e sigurisë qytetare dhe publike. ■ Ofron informacione dhe materiale për organizatat që zhvillojnë programe kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Burimi: Policimi në komunitet për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm: Një vlerësim i procesit në Los Anxhelos. Raport për Zyrën e Programeve Universitare, Drejtoria e Shkencës dhe Teknologjisë, Departamenti i Sigurisë Kombëtare të SHBA-së 2017. E disponueshme në: www.start.umd.edu/pubs/START_CSTAB_Community_Policing_to_Counter_Violent_Extremism_July_2017.pdf.

Përfitimet e policimit në komunitet mund të mos jenë lehtësisht të matshme në periudhën afatshkurtër dhe mund të jenë më të prekshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, duke qenë se edhe besimi rritet dhe shtohen e maturohen partneritetet midis policisë dhe publikut të gjerë.

Bashkëpunimi
i policisë me
institucionet e
tjera shtetërore
dhe joshtetërore
për parandalimin
e ekstremizmit të
dhunshëm

Bashkëpunimi i policisë me institucionet e tjera shtetërore dhe joshtetërore për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm

Tashmë pranohet gjerësisht se as policia dhe as ndonjë institucion tjetër nuk mund të punojë i vetëm kundër çështjeve të krimit dhe sigurisë publike. Kjo sepse problemet e krimit kanë shpesh shkaqe të ndërlikuara të cilat nevojiten të adresohen nga këndvështrime të ndryshme, duke përdorur një sërë mjetesh, aftësish, fuqish dhe ekspertizash. Për këtë qëllim, puna në partneritet është bërë një tipar më i spikatur i policisë në vendet perëndimore gjatë pesë dekadave të fundit.¹³ Edhe në rastin e Shqipërisë, siguria publike ka pësuar një ridimensionim të punës në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarit, si pasojë e zbatimit të procesit të decentralizimit dhe ndryshimit të konceptit të sigurisë në komunitet. Me miratimin e Strategjisë së re Ndërsektoriale për Sigurinë në Komunitet 2021-2026 dhe Planit të Veprimit 2021-2023, siguria në komunitet përshkruhet si përgjegjësi e të gjithë aktorëve përgjegjës në këtë fushë, e cila kërkon një gjithëpërfshirje të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, të cilat kanë detyrimin ligjor për garantimin e sigurisë në komunitet.¹⁴ Në këtë mënyrë, siguria publike nuk do të jetë më kompetencë vetëm e Policisë së Shtetit, duke shfrytëzuar qasjen e deritanishme vertikale në garantimin e rendit dhe sigurisë, por ky koncept tashmë do të jetë më demokratik dhe në rrafshin horizontal, duke mbledhur së bashku të gjithë aktorët institucionalë qendrorë dhe vendorë, institucionet ligjzbatuese, Policinë e Shtetit, qytetarët dhe komunitetet, institucionet e tjera joqeveritare, forumet qytetare, bizneset, institucionet fetare dhe mediat, në mënyrë që të krijohet një kulturë të re e sigurisë publike. Kjo qasje është në linjë edhe me policimin në komunitet, qëllimi i të cilit është të shërbejë si një strategji organizative që i lejon policisë dhe komunitetit të punojnë së bashku për të zgjidhur problemet e rendit dhe çështjet e sigurisë, dhe për të përmirësuar cilësinë e jetesës së gjithsecilit në komunitet.¹⁵ Pra, policimi në komunitet është një proces që i jep mundësinë policisë që në partneritet me palët e interesuara të realizojë misionin dhe përgjegjësitë e saj.

••••

13 Crawford dhe Cunningham 2015; Berry e të tjerë 2011.

14 Strategjia Ndërsektoriale për Sigurinë në Komunitet 2021-2026 dhe Plani i Veprimit 2021 – 2023

15 Rregullore e Policisë së Shtetit (2015)

Në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, është përcaktuar se rritja e radikalizimit fetar rrezikon vlerat e harmonisë fetare në Shqipëri dhe që mund të shkaktojë tension shoqëror.¹⁶ Ndonëse radikalizmi fetar është klasifikuar në rreziqet e nivelit të dytë, shfaqja e tij vlerësohet si me pasoja të larta për sigurinë kombëtare.¹⁷ Në luftën ndaj radikalizimit, bashkëpunimi ndërinstytucional është thelbësor për identifikimin e hershëm dhe të efektshëm të individëve në rrezik, përmirësimin e ndarjes së informacionit, vendimmarrjen e përbashkët dhe veprimin e bashkërenduar.

Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me institucionet e tjera shtetërore

Strukturat e Policisë së Shtetit bashkëpunojnë me të gjithë institucionet e tjera shtetërore për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi Policia e Shtetit do të jetë në gjendje:

- **Të rrisë ndërgjegjësimin** midis institucioneve të tjera shtetërore, në lidhje me kërcënimin e terrorizmit dhe ekstremizmin e dhunshëm, dhe çfarë mund të bëjnë ata. Kjo mund të ketë të bëjë me dhënien e informacionit të përgjithshëm dhe raportimeve specifike për situatën lokale.
- **Të angazhojë institucione** të tjera për vlerësimin e situatës lokale, në veçanti për sa i përket mënyrës se si terrorizmi dhe antiterrorizmi përceptohen mes sektorëve të publikut; shqetësimet e mundshme në lidhje me individë apo grupe specifike, si edhe ndikimi i masave antiterroriste në komunitet.
- **Të përfshijë institucione të tjera** gjatë planifikimit të angazhimit të tyre. Policia mund të përfitojë nga përvoja e agjencive të tjera. Policia, mund ta shohë më efikase të lejojë një agjenci tjetër të drejtojë apo të ndihmojë në krijimin e kontakteve me një grup apo individë të veçantë.
- **Të informojë institucione të tjera** në lidhje me angazhimet e planifikuara apo në vijim dhe të kërkojë informacion nga agjenci të tjera për mënyrën se si këto aktivitete shihen nga komuniteti.
- **Të sigurohet** që institucione të tjera shtetërore të jenë të pranishme gjatë takimeve në komunitet, ku mund të ngrihen çështje që kanë lidhje me parandalimin e terrorizmit dhe përballjen me ekstremizmin e dhunshëm.

16 Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë 2014; Shtojca C: Klasifikimi i rreziqeve; 25.

17 Po aty.

Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me rininë

Të rinjtë kanë tendencë të përdorin metoda të ndryshme komunikimi dhe marrin informacion nga burime të ndryshme në krahasim me ato që përdoren nga më të rriturit. Për shumë të rinj, jeta sociale dhe miqësitë mbahen kryesisht përmes mediave dhe rrjeteve sociale. Përdorimi i medias sociale mund të jetë një mjet efikas për të siguruar bashkëveprimin me të rinjtë dhe për t'u komunikuar atyre mesazhe të rëndësishme. Përpjekjet për angazhimin e të rinjve në përpjekjet për parandalimin e terrorizmit dhe përbaljen me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, mund të bazohen në angazhimin e rinisë në parandalimin e sjelljeve të tjera me risk dhe krimeve, duke përfshirë dhunën në shkolla, pjesëmarrjen në kriminalitet, abuzimin me drogat, trafikimin dhe shfrytëzimin për qëllime seksuale. Disa nga qasjet e mundshme të bashkëpunimit të Policisë me të rinjtë, përfshijnë:

- **Kryerjen e aktiviteteve sportive**, aktivitete të fushës së artit dhe aktivitete rinore, si instrumente për nisjen e kontaktit, krijimin e një platforme për ndërveprim të vazhdueshëm dhe nxitjen e mënyrave paqësore të shprehjes.
- **Këshillimin** për parandalimin e terrorizmit, si pjesë e nismave për ndërgjegjësimin e përgjithshëm të të rinjve rreth sigurisë.
- **Vendosjen e pranisë** në median sociale për të bashkëvepruar me të rinjtë, duke përfshirë edhe vendosjen e një dialogu aktiv në lidhje me incidente të diskutueshme.
- **Ndërtimin** ose mbështetjen e nismave të ndryshme, ku të rinjtë të cilët kanë fituar tashmë disa aftësi (p.sh. si trajnerë sportivë në projekte komunitare arti apo në veprimtari të tjera) t'i ndajnë këto aftësi me moshatarët e tyre dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre së bashku.
- **Ftesën e të rinjve** për të kontribuar në trajnimin e policisë, në veçanti për aktivitete që kanë tendencën të kenë ndikim të shpërpjesëtuar tek të rinjtë, si p.sh., ndalimet dhe kontrollet. Të tilla iniciativa ofrojnë një mundësi qoftë për të rinjtë, qoftë për policinë, për t'u njohur më mirë dhe për të shkëmbyer mendime për mënyrat se si të rinjtë mund të ndikohen nga disa prej masave policore.
- **Organizimin e aktiviteteve** ku të rinjtë mund të mësojnë mbi aktivitetet e policisë dhe t'i përjetojnë ato. Kjo ka për qëllim çmimizimin e veprimeve dhe përjasjeve të policisë, në mënyrë që të rinjtë të kuptojnë më mirë taktikat policore në trajtimin e krimeve.
- **Ndërtimin e programeve edukative** për të rinjtë, të cilët mund të jenë të interesuar për t'u bashkuar radhëve të policisë.
- **Përfitim** nga aftësitë ndërmjetësuese që kanë disa individë me besueshmëri mes të rinjve.

Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me organizatat për të drejtat e grave/vajzave

Strukturat e policisë duhet të realizojnë bashkëpunim me të gjithë organizatat e grave/vajzave, të cilat në misionin e tyre kanë mbrojtjen e të drejtave të grave/vajzave, në funksion të parandalimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim shmangien e paragjytimeve të mundshme, në veprimet e saj për parandalimin e terrorizmit dhe në përballje me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm, duhet:

- **Të jenë të angazhuara** dhe të kërkojnë vazhdimisht të arrijnë objektivin e barazisë gjinore dhe mbrojtjes së të drejtave të grave/vajzave në të gjitha veprimtaritë policore dhe jo thjesht në lidhje me ndihmën që mund të jepet në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm.
- **Të përfshijnë dhe angazhojnë gratë/vajzat** në të gjitha fazat e zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të strategjive, politikave dhe masave kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm; si dhe të kërkojnë pjesëmarrjen aktive të grave në konsultimet midis policisë dhe komunitetit.
- **Të përfshijnë standarde specifike gjinore** gjatë monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të efikasitetit, si edhe ndikimet pozitive dhe negative të politikave dhe masave të tyre kundër ekstremizmit të dhunshëm.
- **Të rrisin praninë e grave/vajzave midis radhëve të policisë**, të përfshira në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm, dhe në angazhimin e publikut për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, në të gjitha nivelet dhe për të gjitha funksionet, si dhe të heqë pengesat për rekrutimin, mbajtjen e tyre në punë dhe për ecjen në karrierë.
- **Të nxisin bashkëpunimin me institucione të tjera qeveritare** për të diskutuar dhe kuptuar më mirë implikimet gjinore në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.
- **Të organizojnë trajnime të detyrueshme** për çështjet gjinore për të gjithë punonjësit e policisë.
- **Të identifikojnë aktivistët dhe organizatat e grave/vajzave** (qoftë edhe organizata të vogla), të evidentojnë aftësitë dhe nevojat e tyre; të ndërtojnë partneritete reale me organizatat e grave bazuar mbi idenë e bashkëveprimit aktiv në ndjekje të objektivave të përbashkëta. Policia duhet të jetë transparente në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me parandalimin e terrorizmit, por duke u përpjekur të trajtojë si fillim shqetësimet parësore dhe më të gjera të grave/vajzave në lidhje me sigurinë e komuniteteve të tyre.
- **Të përfshijnë rritjen e ndërgjegjësimit** në lidhje me rreziqet dhe reagimet e mundshme ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si pjesë e iniciativave për informimin e grave/vajzave në lidhje me masat për trajtimin e

çështjeve të tjera që lidhen me sigurinë dhe kriminalitetin, të tilla si: dhuna në familje apo abuzimi seksual etj;

- **Të inkurajojnë** dhe të mbështesin iniciativa që fuqizojnë pjesëmarrjen e grave/vajzave në sferën publike, në mënyrë që ato të luajnë një rol aktiv në trajtimin e radikalizimit terrorist në komunitetin e tyre, duke shmangur krijimin e rreziqeve të sigurisë dhe sigurimit për gratë/vajzat e përfshira në të tilla iniciativa.
- **Të mbështesin garantimin** e platformave dhe hapësirave të sigurta për gratë/vajzat për shkëmbimin e burimeve, përvojave dhe shqetësimeve, në përballjet me radikalizmin e dhunshëm, duke përfshirë aftësitë dhe instrumentet për të reaguar më me efikasitet.
- **Të mbështesin nismat e shoqërisë civile** për edukimin e grave/vajzave në lidhje me historinë e tyre kulturore, fetare dhe politike, duke pranuar që do të ketë interpretime të ndryshme, për t'u krijuar atyre kushte për hartimin dhe diskutimin e mesazheve të ndryshme normative, kundër historive ekstremiste.
- **Të sigurojnë që gratë/vajzat** të kenë akses më të mirë ndaj programeve që marrin në konsideratë çështjet gjinore për t'u shkëputur nga radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm, dhe që kjo t'u garantojë atyre mbrojtjen dhe mbështetjen e duhur.
- **Të shmangin bashkëpunimin** vetëm për qëllimin e mbledhjes së informacionit.

Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me institucionet fetare

Është shumë e rëndësishme që përpjekjet e Policisë në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm të mos jenë diskriminuese apo që ato pa dashje të jenë stigmatizuese ndaj ndonjë feje apo besimi fetar në veçanti. Ekstremistët e dhunshëm mund të përmendin një sërë arsyesh për të justifikuar veprimet e tyre, duke përfshirë edhe shtrembërimin e çështjeve të besimit fetar, për të arritur qëllimet e tyre. Policia duhet të bashkëveprojë me drejtuesit e institucioneve fetare dhe organizatat me bazë fetare për disa arsye, duke përfshirë:

- **Institucionet fetare dhe komunitetet e tyre** mund të jenë objektiva të mundshme të sulmeve terroriste.
- **Institucionet fetare mund të jenë burime shumë të rëndësishme informacioni** për mënyrën se si masat antiterrorizëm kanë ndikuar në komunitetet e tyre dhe se si ato perceptohen prej tyre.
- **Institucionet fetare mund të ndihmojnë autoritetet e Policisë së Shtetit** të kuptojnë më mirë komunitetet e tyre dhe të përshtatin, për rrjedhojë, iniciativat e bashkëpunimit me to.
- **Institucionet fetare mund të kenë dijeni** mbi praninë e individëve apo materialeve që qarkullojnë brenda komunitetit të tyre, të cilët tregojnë histori që justifikojnë terrorizmin.

- **Informacioni i siguruar prej institucioneve fetare** mund t'i vijë në ndihmë policisë për të vlerësuar nëse historitë që justifikojnë terrorizmin po fitojnë terren mes individëve të caktuar.
- **Institucionet fetare mund të jenë më mirë të pozicionuar** për të kundërshtuar gjallërisht dhe në mënyrë efektive disa aspekte të historive që përdorin terroristët për justifikimin e terrorizmit.

Drejtuesit e strukturave të policisë dhe punonjësit e policisë për të pasur sukses gjatë bashkëpunimit me drejtuesit e institucioneve fetare dhe organizatat me bazë fetare, duhet:

- **Të ndërtojnë dhe bazojnë bashkëveprimin** mbi një kuptim të saktë të demografisë, dinamikave dhe kompleksiteteve lokale të komuniteteve fetare.
- **Të përdorin një qasje reflektive** për identifikimin dhe mohimin e stereotipave dhe paragjykimeve që mund të kenë ndaj besimeve fetare të personave me të cilët ata kërkojnë të bashkëpunojnë.
- **Të tregojnë se kanë njohje** dhe nëse mundet, edhe ndjeshmëri ndaj besimeve fetare, ndonëse nuk është e nevojshme apo praktikisht e mundur që të pretendohet që punonjësit e policisë të kenë të njëjtat besime fetare me ato të komunitetit me të cilin kërkojnë të bashkëpunojnë.
- **Të bëjnë të qartë** që nga fillimi që nuk ia vënë fajin fesë për terrorizmin, radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm, si dhe ta kundërshtojnë në mënyrë aktive shoqërizimin e terrorizmit me fenë, përmes bashkëveprimit me komunitetet e tjera dhe publikun në përgjithësi.
- **Të shpjegojnë** se si angazhimi pozitiv i drejtuesve të institucioneve fetare dhe organizatave fetare në parandalimin e terrorizmit dhe përballjen me ekstremizmin e dhunshëm është në interes të ruajtjes së komuniteteve.
- **Të bëjnë çdo përpjekje** që të mos duket sikur po favorizojnë një grup më shumë se tjetrin dhe të mos merren vetëm me bashkëbisedues të caktuar.
- **Të bashkëbejnë me drejtuesit** dhe organizatat nga të gjitha besimet fetare dhe t'i nxisin ata të mobilizohen së bashku për të denoncuar dhunën terroriste dhe për të shprehur solidaritetin me të gjitha viktimat e terrorizmit.

Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me minoritetet etnike

Mundësia që Policia e Shtetit të bashkëpunojë me minoritetet etnike në mënyrë konstruktive, me qëllim parandalimin e terrorizmit, varet nga konteksti më i gjerë i marrëdhënieve të policisë me minoritetet etnike dhe integrimi i burrave dhe grave nga minoritetet etnike në shoqëri. Policia mund të bazohet tek përpjekjet ekzistuese për zbatimin e praktikave të mira të policimit në shoqëritë multi-etnike, si edhe në

iniciativa të tjera për të mundësuar pjesëmarrjen e burrave dhe grave nga minoritetet etnike në jetën publike. Terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk lidhet me asnjë nacionalitet, komb apo grup etnik të caktuar. Megjithatë, diskriminimi dhe stigmatizimi i minoriteteve etnike, mund të çojë në ftohjen, largimin dhe armiqësinë e tyre drejt policisë. Kjo, nga ana tjetër, mund të ulë ndjeshëm gatishmërinë e minoriteteve etnike për bashkëpunim dhe mbështetje të policisë për parandalimin e terrorizmit dhe në përballjen me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Drejtuesit e strukturave të policisë do të kishin më shumë efikasitet gjatë bashkëveprimit me minoritetet etnike për parandalimin e terrorizmit dhe përballjen me ekstremizmin e dhunshëm, nëse:

- **Mbështeten tek punonjësit e policisë** që kanë vendosur si pika kontakti në marrëdhënie me persona nga minoritetet etnike.
- **Qartësojnë** se një komunitet i caktuar etnik nuk shihet si problem apo si grup i dyshuar.
- **Kontaktojnë me individët dhe organizatat** nga të gjitha minoritetet etnike.
- **Garantojnë** se çdo forum formal apo joformal, për ndërveprim me komunitetet, të jetë i hapur për të gjithë segmentet e publikut, duke përfshirë minoritetet etnike.
- **U ofrojnë** minoriteteve etnike informacion në gjuhën e tyre, kurdoherë që të jetë e mundur.
- **Janë në dijeni** në lidhje me gjuhën, doket, historikun dhe besimet fetare të minoritetit etnik.
- Pranojnë ekzistencën e marrëdhënieve të dobëta midis policisë dhe minoritetit etnik me të cilin synojnë të ndërveprojnë, duke demonstruar përpjekje të vërteta për rivendosjen e marrëdhënieve.
- **Bashkëveprojnë** me një grup personash që i përkasin minoritetit etnik me të cilin ata do të bashkëveprojnë burra dhe gra, të rinj dhe të moshuar.
- **Nuk e kufizojnë** angazhimin e tyre vetëm tek përballja me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm, por trajtojnë me vërtetësi një gamë të gjerë çështjesh dhe shqetësimesh të mundshme për minoritetet etnike.
- **Pyesin, dëgjojnë dhe zgjidhin** shqetësimet e minoriteteve etnike në lidhje me përballjen me ekstremizmin e dhunshëm.
- **Shpjegojnë** pse përfshirja proaktive e minoriteteve etnike në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, është në interes të ruajtjes së komuniteteve.

Bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me organizatat e shoqërisë civile (OSHC)

Është shumë e rëndësishme të sigurohet bashkëpunimi i Policisë së Shtetit me organizatat e shoqërisë civile në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të

dhunshëm. Duke qenë se organizatat e shoqërisë civile janë shumë të rëndësishme për jetën publike dhe për rrjetet e shkëmbimit të informacioneve, Policia e Shtetit duhet të përpiqet t'i angazhojë dhe t'i përfshijë ato në zhvillimin e partneriteteve. Drejtuesit e strukturave qendrore dhe vendore të policisë, si dhe të gjithë punonjësit e policisë, duhet:

- **T'i konsiderojnë OSHC-të** si partnere të pavarura dhe të barabarta për trajtimin e shqetësimeve dhe çështjeve të përbashkëta të sigurisë brenda komunitetit.
- **Të bashkëpunojnë me OSHC-të** e ndryshme, që përfaqësojnë komunitete të ndryshme dhe trajtojnë çështje të ndryshme.
- **Të bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive** edhe me OSHC-të që kanë qenë kritike për punën e policisë.
- **Të garantojnë mbrojtjen e anëtarëve të OSHC-ve** dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut, në veçanti integritetin e tyre fizik, në ato raste kur si pasojë e angazhimit të tyre në luftën për parandalimin e terrorizmit kjo ka rezultuar në ngacmime apo persekutim.
- **Të shkëmbejnë, sipas kuadrit ligjor** informacion të përshtatshëm dhe të saktë me OSHC-të, për sa i takon vlerësimin nga policia të kërcënimeve terroriste, në mënyrë që këto organizata të japin opinione, këshilla dhe asistencë të vlefshme.
- **Të mos i trajtojnë OSHC-të me dyshim**, me përjashtim të rasteve kur ka arsye të vërteta dhe objektive për ta bërë një gjë të tillë, sidomos në angazhimet me individë dhe grupe të prekshëm nga radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm, për t'i kuptuar ata më mirë dhe/ose për t'i kthyer ata nga rruga e radikalizimit terrorist.
- **Të mos i kufizojnë veprimtaritë e OSHC-ve**, me përjashtim kur kjo është vendosur nga një gjykatë, sipas standardeve të gjykimit të lirë dhe të ndershëm.
- **Të marrin në konsideratë angazhimin e OSHC-ve**, për trajnimin e punonjësve të policisë në lidhje me çështje të diversitetit, mosdiskriminimit, të drejtave të njeriut, çështjeve gjinore në përgjithësi dhe veçanërisht, në kontekstin e antiterrorizmit.

Roli i policisë
në procesin e
rehabilitimit
dhe riintegrimin
të personave të
kthyer nga zonat
e konfliktit

Roli i policisë në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin të personave të kthyer nga zonat e konfliktit

Koncepti i “luftëtarëve të huaj” nuk është një shpikje moderne, pasi luftëtarët e shteteve të huaja kanë marrë pjesë në gati 100 luftëra civile gjatë 250 viteve të fundit.¹⁸ Lufta Civile në Spanjë (1936–1939), e cila mbledhi rreth 50 000 vullnetarë nga më shumë se 50 vende të ndryshme, që luftonin në të dyja krahët e konfliktit, është shembulli më i njohur.¹⁹ Termi “luftëtar i huaj” u përdor për herë të parë zyrtarisht duke iu referuar luftëtarëve që vinin jashtë vendeve të zonës së konfliktit për të luftuar përkrah Al-Kaedës në Afganistan. Më pas, termi “luftëtar i huaj” u përdor në kontekstin e kryengritjes së udhëhequr nga terroristët në Irak në vitin 2003. Në rastin e Shqipërisë, termi u përdor duke iu referuar qytetarëve të larguar përgjatë viteve 2012-2014 drejt konfliktit në Siri dhe Irak.

Një nga përkufizimet më të pranuar është ai i Akademisë së Gjenevës për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare dhe të Drejtat e Njeriut:

*“Një luftëtar i huaj është një individ që largohet nga vendi i tij ose i saj i origjinës, ose vendbanimi i zakonshëm për t’u bashkuar me një grup të armatosur joshitetëror, në një konflikt të armatosur jashtë shtetit dhe i cili është i motivuar kryesisht nga ideologjia, besimi dhe/ose farsfnia”.*²⁰

Duke pasur parasysh se një pjesë e shtetasve shqiptarë të larguar në Siri kanë filluar të riatdhesohen,²¹ është me rëndësi që të vlerësohet procesi i rehabilitimit dhe riintegrimin të këtyre shtetasve. Rehabilitimi është faza kur personat përgjegjës ndërmarrin ndërhyrje për të trajtuar sjelljen dhe aftësitë njohëse të personave të kthyer, si dhe zhvillojnë aktivitete përgatitore për të përforcuar qëndresën personale të individit ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe për t’i përgatitur ata për riintegrim

••••

- 18 David Malet, *Luftëtarët e Huaj: Identiteti Mbikombëtar në Konfliktet Civile*, Oxford University Press, 2015.
- 19 Sebastiaan Faber, *Luftëtarët e Huaj të Spanjës*, Foreign Affairs. Shtator-Tetor 2016.
- 20 Akademia e Gjenevës për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare dhe të Drejtat e Njeriut, *Luftëtarët e Huaj në të Drejtën Ndërkombëtare*, Academy Briefing No. 7, Tetor 2014.
- 21 Faza e parë e riatdhesimit u zhvillua në tetor të vitit 2020 kur një grua dhe katër fëmijë u kthyen në Shqipëri, ndërsa faza e dytë u zhvillua në gusht të vitit 2021 kur u riatdhesuan pesë gra dhe 14 fëmijë. Procesi i riatdhesimit të rreth 56 shtetasve të mbetur, është në vijim.

shoqëror. Kjo mund të ndodhë pas fazës së shkëputjes dhe/ose deradikalizimit dhe gjithashtu mund të ndodhë në të njëjtën kohë me këto procese. Veçanërisht, në kontekstin e luftës ndaj ekstremizmit të dhunshëm, rehabilitimi përqendrohet në qëndrueshmërinë e posaçme ndaj ekstremizmit të dhunshëm, duke i rezistuar tërheqjeve të grupit të tyre të mëparshëm dhe siguron gatishmërinë e individit për riintegrim funksional shoqëror dhe largimin nga sjellja kriminale. Riintegrimi është faza ku punonjësit e shërbimeve sociale ndihmojnë kalimin e individit të rehabilituar përsëri në “kushtet e dëshiruara” në shoqërinë e zakonshme. Në të njëjtën kohë, punonjësit e shërbimeve sociale në bashkëpunim edhe me aktorë të tjerë shtetërorë dhe joshetërorë, punojnë me komunitetin specifik ku ai individ përfundimisht do të banojë, për të zbutur stigmën sociale dhe të punojnë drejt pranimit të atij individ në shoqëri.

Është me rëndësi të theksohet se në disa raste, kjo fazë në të vërtetë mund të konsiderohet “integrim” më shumë se “riintegrim”, për shkak të rrethanave të mëparshme shoqërore të individit për të mos u integruar në fillim. Në çdo rast, nëse profili i të kthyerit nuk orientohet për hetim/ndjekje penale, duhet mbajtur në vëmendje, nevoja urgjente për angazhimin e individit të kthyer, menjëherë në programe rehabilituese të bazuara në identifikimin e nevojave individuale, familjare, shëndetësore, arsimore, psikologjike dhe sociale për të rivendosur besimin tek strukturat shtetërore.

Rehabilitimi dhe riintegrimi i fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit duhet të ketë përparësi. Kjo përfshin aksesin në shërbimet e përshtatshme sipas moshës dhe gjinisë, duke përfshirë shëndetin mendor dhe mbështetjen psikosociale, edukimin dhe ndihmën ligjore. Koordinimi i kujdesit alternativ duhet të garantohet edhe në ato situata kur fëmijët nuk mund të qëndrojnë me prindërit e tyre ose kur nuk është në interesin më të mirë të fëmijës të qëndrojnë me ofruesin e kujdesit parësor.

Strukturat e specializuara të Policisë së Shtetit kryejnë vlerësimin e rrisht, si një proces që përfshin grumbullimin sistematik dhe interpretimin e informacionit që ka të bëjë me një individ për t’u siguruar të dhëna në lidhje me, se sa janë gjasat që një individ i caktuar të angazhohet në veprime të dëmshme dhe për të vlerësuar natyrën dhe ashpërsinë e këtij dëmi.

Disa komunitete vendore mund të ofrojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e pikëpamjeve të dhunshme ekstremiste dhe mund të mos kenë interes për programet e rehabilitimit dhe riintegrimit. Në këto raste, është me rëndësi të investohet në përpjekjet për të forcuar qëndrueshmërinë e komunitetit dhe për të zbutur rrezikun e përsëritjes dhe radikalizimit nga të kthyerit. Nga ana tjetër, disa familje dhe komunitete të tjera mund të refuzojnë angazhimin në programet e rehabilitimit dhe riintegrimit për shkak të frikës dhe stigmës. Këtu është e rëndësishme të vendoset një strategji komunikimi e hartuar me kujdes dhe një plan veprimi i përshtatshëm për të nxitur angazhimin e komunitetit.

Në punën e punonjësve të Policisë së Shtetit bëhet fillimisht identifikimi i personave të kthyer nga zonat e konfliktit dhe koordinohet ndërmjet institucioneve për rehabilitimin dhe rintegrimimin e tyre. Strukturat e specializuara të Policisë së Shtetit përgatitin dosjen për çdo person që është larguar për në Siri (ndjekjen dhe hetimin, parandalimin e veprimeve rekrutuese dhe përfshirjen me familjen, sidomos për çështjet e mbrojtjes së fëmijës dhe çështjet e abuzimeve me fëmijët etj). Krahas dosjes individuale, strukturat e specializuara të policisë përgatisin planet e masave për komunikimin, burimet e disponueshme, procedurat e nevojshme etj. Strukturat e Policimit në Komunitet, luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e rehabilitimit dhe rintegrimimit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit. Ndihmës Specialistët e Policimit në Komunitet në Komisariatet e Policisë gjatë procesit të rehabilitimit dhe riintegrimimit të personave të kthyer nga zonat konfliktit, kryejnë këto detyra:

- Evidentojnë personat e kthyer nga zonat e konfliktit të cilat janë dënuar penalisht nga gjykata dhe personat e tjerë që janë në proces hetimi penal.
- Evidentojnë personat e kthyer nga zonat e konfliktit që nuk janë dënuar nga gjykata dhe nuk janë në proces hetimi penal, përfshirë gra dhe fëmijë.
- Evidentojnë fëmijët të lindur në zonat e konfliktit pa nënshtetësi.
- Evidentojnë personat që marrin në kujdestari fëmijë të kthyer nga zonat e konfliktit, në rastet kur prindërit mund të jenë vvarë, janë në burg apo janë të sëmurë mendorë dhe u është hequr e drejta me vendim gjykate.
- Evidentojnë adresat e banimit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit.
- Mbajnë kontakte të vazhdueshme dhe bashkëpunojnë me të gjithë aktorët vendorë, të tillë si: drejtues të shkollave, personelin e shërbimeve sociale në bashki, personelin e mbrojtjes së fëmijëve, njësitë e qeverisjes vendore, apo OSHC-të e ndryshme, në funksion të mbarëvajtjes së procesit të riintegrimimit dhe rehabilitimit, si dhe evidentimit të problematikave dhe përcaktimi i masave për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.
- Identifikojnë personat që janë përfshirë në procesin e radikalizimit (bëhet fjalë për persona në fazën e hershme të radikalizimit, të cilët nuk e pranojnë ende dhunën si formë legjitime në zgjerimin dhe mbrojtjen e bindjeve të tyre) dhe bashkëpunojnë me institucionet e tjera shtetërore dhe joshtetërore për trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve që i çojnë ata në ekstremizëm të dhunshëm.
- Sigurojnë informacion për problematika të ndryshme që mund të kenë personat e kthyer nga zonat e konfliktit dhe ndarja e problematikave me institucionet shtetërore dhe joshtetërore përkatëse, për trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre problematikave.
- Sigurojnë mbështetjen e institucioneve të tjera shtetërore dhe joshtetërore të angazhuara në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimimit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit, në të gjithë rastet kur kërkohet nga këto institucione.
- Merr pjesë në aktivitetet e përbashkëta që zhvillohen nga aktorë të tjerë (kur

nga ana e aktorëve vlerësohet e domosdoshme edhe prezenca e punonjësit të policisë), në funksion të procesit të rehabilitimit dhe riintegrit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit.

- Punojnë me komunitetin specifik ku personat e kthyer do të banojnë, së bashku me aktorët e tjerë shtetërorë dhe joshtetërorë, për të zbutur stigmën sociale dhe pranimin e tyre në shoqëri.
- Bashkëpunojnë dhe koordinojnë me strukturat e specializuara të Policisë së Shtetit.
- Trajtojnë informacionin e klasifikuar sipas akteve ligjore e nënligjore.
- Kryejnë vlerësimin e rrishtit për çdo person të kthyer nga zonat e konfliktit, duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët e tjerë shtetërorë dhe joshtetërorë, të përfshirë në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit.
- Informojnë eprorin për të gjitha çështjet dhe problematikat e evidentuara gjatë procesit të rehabilitimit dhe riintegrit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit.

Konsideratat
etike dhe
zbatimi i të
drejtave të
njeriut gjatë
veprimeve të
policisë

Konsideratat etike dhe zbatimi i të drejtave të njeriut gjatë veprimeve të policisë

Aktet dhe kërcënimet e ekstremizmit të dhunshëm ndikojnë negativisht në të drejtat themelore të njeriut, dëmtojnë paqen, sigurinë, zhvillimin dhe përkeqësojnë tensionet dhe dobësitë shoqërore. Por nga ana tjetër, edhe masat që miratojnë shtetet në luftën kundër terrorizmit gjithashtu mund të shkelin të drejtat e njeriut, diskriminojnë, nxisin pandëshkueshmërinë, dhe e bëjnë më të vështirë jetesën. Është me rëndësi që punonjësit e policisë të kujdesen për respektimin e të drejtave të njeriut gjatë veprimeve kundër ekstremizmit të dhunshëm, pasi e kundërta do të stimulonte një rreth vicioz nga i cili lulëzon ky fenomen. Ekstremizmi i dhunshëm ushqehet nga ndjenjat e zemërimit dhe zhgënjimit të shkaktuar nga pabarazitë, qeverisja e dobët, dobësitë në institucionet e sundimit të ligjit dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, të cilat i mundësojnë grupeve ekstremiste të dhunshme të përhapin ideologjitë e tyre dhe të rekrutojnë njerëz të rinj.²² Veprimet kundër ekstremizmit të dhunshëm duhet të konsiderohen me kujdes duke pasur parasysh ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në të drejtat themelore, përfshirë të drejtën për lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë dhe opinionit, si dhe e drejta për trajtim të drejtë në përputhje me sundimin e ligjit.²³

Veprimet e punonjësve të policisë për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm duhet të jenë gjithmonë në përputhje me rregullat dhe etikën e Policisë së Shtetit, siç parashikohen në Rregulloren²⁴ e Policisë:

- Në ushtrimin e funksioneve mbron në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetuese dhe ligjore të individit.
- Nuk kryen, nxit apo toleron asnjë akt torture, trajtim çnjerëzor ose poshtërues në çfarëdo rrethane.
- Përbush detyrat në përputhje me të drejtat themelore të individit. Ai udhëhiqet nga parimi i barazisë, lirisë së mendimit, të shprehjes, të besimit, të grumbullimit

••••

- 22 Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut, si një gur themeli për ndërtimin e qëndrueshmërisë kundër terrorizmit. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Luftën ndaj Terrorizmit, 2020. E disponueshme në www.un.org/counterterrorism/sites/www.un.org.counterterrorism/files/cn_day_iv_wwbinar_iv_human_rights_building_resilience.pdf.
- 23 Për më shumë shih www.un.org/securitycouncil/ctc/content/global-implementation-surveys.
- 24 Rregullore e Policisë së Shtetit, 2015.

paqësor, lëvizjes së lirë dhe të drejtës mbi pronën.

- Nuk privilegjon apo diskriminon asnjë për shkak të përkatësisë etnike, racore, gjinore, gjuhësore, politike apo çdo bindjeje tjetër, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual apo rrethane tjetër personale.
- Trajton të gjithë subjektet në mënyrë të ndershme, të drejtë e të paanshme, si dhe shmang konfliktin e interesit që do të cenonte drejtësinë dhe paanësinë.
- Nuk pengon drejtësinë, ai nuk fsheh apo përdor informacione, me qëllim përkrahjen apo dëmtimin e një personi.
- Zbaton detyrat me profesionalizëm dhe korrektësi, jashtë çdo ndikimi politik, përkatësie fetare, racore, gjinie apo përkatësie etnike.
- Nuk merr vendime të njëanshme dhe të ndikuara politikisht në lidhje me emërimet, ecurinë në karrierë, si dhe në zgjidhjen e problemeve gjatë ushtrimit të funksioneve.
- Vepron në çdo kohë me ndershmëri dhe integritet të plotë. Ai deklaron çdo interes privat në lidhje me detyrën.
- Merr vendimet në respekt të parimit të interesit publik dhe jo për përfitime financiare, personale, apo të personave të afërt me të.

